



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 40

Datë: 08. 12. 2022. Ora: 15:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 3. Raport për aktivitetet e Zyrës**
- 4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtar për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zvečan, që do të mbahen me datën 18.12.2022

Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës dhe Vlerësim i Qendrave të Votimit në Kosovë

Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës Gjinore dhe Moshës së Lidërshipt të Partive politike: 2017-2021

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarëve të Kuvendit Komunal në Prishtinë

5. Të ndryshme!

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Në fillim të mbledhjes, kryetari Radoniqi paraqiti agjenden e mbledhjes, dhe pyeti për dakordimin e agjendës së takimit. **Sami Kurteshi**, kërkoi që të raportoj këshilli për çështje ligjore, kurse zëvendësimet janë shkurt, ndërsa tha se në këshillin e operacioneve janë dy çështje për tu shqyrtuar. Kryetari **Radoniqi**, plotësoi agjendën edhe me një pikë të këshillit për marrëdhënie me jashtë, ndërsa **Arianit Elshani**, tha se shqyrtimi i analizës për qendrat e votimit në Kosovë, të hiqet nga rendi i ditës...dhe tjetra, analiza e moshës gjinore të lidërshipt të partive politike sepse, i kemi pikat e shqyrtimit të zgjedhjeve... Unë, tha Elshani kam rekomandime për vendosjen e pikave, rritjen e numrit të votuesve për vendvotime, pastaj shqyrtimi i dizajnit për fletëvotime dhe broshura, numri i prodhimit të fletëvotimeve dhe broshurave, shqyrtimi i raportit për numrin përfundimtar të votuesve, miratimi i listës së QV-ve për këto komuna, zëvendësimi i anëtarit të kuvendit komunal në Zubin Potok dhe, miratimi i planit të sigurisë...Dhe një kërkesë, në të ndryshme...

Kreshnik Radoniqi: Hiqen dy pika nga KOZ, dhe po shtohen 7 pika tjera ! Kush është për...?

Me 11 vota, miratohet rendi i ditës.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj, tha se pas certifikimit të listës përfundimtare të votuesve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunave, procesi i ardhshëm në kuadër të këtij aktiviteti, “Shtypja, kontrollimi, paketimi dhe transportimi i Listave përfundimtare të votuesve dhe listave komunale të votuesve”. Lidhur me këtë do të formohet Komisioni i pranimit i cili duhet të jetë i pranishëm në

ambientet ku bëhet shtypja dhe kontrollimi i listave përfundimtare të votuesve dhe listave komunale të votuesve, në mënyrë që ta mbikëqyr paketimin e materialeve dhe llogaritjen e materialeve sipas sasisë së planifikuar. Shtypja, kontrollimi, paketimi dhe transportimi i LPV dhe LKV, është i planifikuar të ndodhë në datat: 10 - 15 dhjetor 2022. Në kategorinë e parë e VPNV-ve, që ka filluar me datën 26.11.2022 dhe përfunduar me datën 01.12.2022 nuk kemi aplikime. Për ndërrim të qendrës së votimit kemi vetëm një aplikim dhe për votim jashtë deri me datën 29.11.2022, kemi pranuar një (1) aplikacion për regjistrim, i cili pas vlerësimit të kriterëve juridike, kërkesa për regjistrim është aprovuar. Aplikacioni është dërguar nga shteti i Gjermanisë, dhe është aprovuar për komunën e Mitrovicës së Veriut.

Më tej në raportin e tij, z. Ahmetaj tha se KKZ-të në komunën e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut kanë diskutuar për situatën e krijuar me 6 dhjetor si dhe përgatitjet rreth zgjedhjeve në këto komuna. Në të gjitha takimet janë sqaruar probleme të njejta me sigurimin e Qendrave të votimit, me përjashtim të 2 Qendrave të votimit në Zveçan dhe një në komunën e Mitrovicës së Veriut e cila ndodhet në lagjen e Minatorëve dhe menaxhohet nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, për qendrat tjera të votimit janë paraqitur veshtirësi për sigurimin e tyre pasi që Drejtorët e Arsimit nëpër Komuna kanë dhënë dorëheqje dhe problemi është kujt ti adresohet kërkesa. Sipas KKZ në Zveçan, objekti i komunës është i mbyllur në terësi përfshirë edhe zyren e KQZ-së në këtë komunë. Në Mitrovicën e Veriut, zyra e KQZ-së është demoluar. Nga këto takime kemi deklarimin e KKZ-ve për Komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok se e kanë të pamundur të veprojnë në një objekt që menaxhohet nga struktura jo të komunës. Po ashtu sipas deklaramit, të anëtarëve të KKZ-së, ata nuk do të shkojnë në asnjë mënyrë në zyre në këto rrethana pasi që është në pyetje siguria fizike në njerën anë dhe në anën tjetër është i pamundur funksionimi i KKZ-së në rrethanat e lartëcekura. KKZ e Zveçanit kanë deklaruar se edhe me përcjelljen e Policisë, në këto rrethana refuzojnë të shkojnë për të punuar.

Por, tha z. Ahmetaj, anëtarët e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, që përbëhen nga përfaqësues të partive politike, kanë deklaruar se nuk do të mundet të kryejnë detyrën e tyre për shkak të rrethanave që ndërlidhen me aspekte të sigurisë. Anëtarët e KQZ-së kërkuar që të shikohet mundësia e zëvendësimit të tyre. Ne, tani kemi të certifikuar listën përfundimtare të votuesve që përmban 44 mijë e 939 emra të votuesve apo 1,189 votues më shumë në krahasim me Zgjedhjet Lokale 2021.

Votuesit janë të shpërndarë në 44 qendra të votimit megjithëse 74 vendvotime. Bazuar në listën përfundimtare të votuesve, numri i votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme të 18 dhjetorit në këto katër komuna është 44,939, ndërsa KQZ-ja ka vendosur që të shtypen 40,900 fletëvotime, pra 4,039 apo 9.87% fletëvotime më pak se votues. KQZ-ja caktoi edhe numrin e fletëvotimeve që do të shtypen për

zgjedhjet e parakohshme të 25 dhjetorit për Kuvendin Komunal të Zveçanit dhe Leposaviqit. Sipas vendimit të KQZ-së, për këto zgjedhje do të shtypen 18,500 fletëvotime, pra 1,771 apo 9.5% fletëvotime më pak se votues. Kjo praktikë e shtypjes më pak fletëvotime se numri i votuesve është ndjekur edhe në proceset e kaluara zgjedhore. Ndërsa, KQZ ka miratuar përbajtjen dhe dizajnin e fletëvotimeve për dy proceset zgjedhore, të 18 dhe 25 dhjetorit 2022. (Bashkangjitur gjeni modelet e fletëvotimeve të miratuara); la mriatuar listën e qendrave të votimit që do të jenë 44 qendra të votimit, ndërsa për zgjedhjet e datës 25 dhjetor, u miratua lista me 25 qendra të votimit.

Po ashtu, ka thënë z. Ahmetaj, KQZ ka marrë vendim për miratimin e planit operacional të KQZ-së për sigurinë e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut si dhe për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Komunal në Leposaviq dhe Zveçan.

Sami Kurteshi: Pe kuptoj situatën, por refuzimi i punës nga KKZ-të po më duket i cuditsëm! Frika është njerëzore, por unë propozoj që SKQZ dhe KQZ të gjithë zyrtarët komunal të angazhohen për këto zgjedhje. Pra, sekretarait të bëjnë një plan se si, ata mund të angazhohen...

Ilir Gashi, tha se një gjë duhet ta qartësojmë: ZLKZ-të nuk kan refuzuar, ata që refuzojnë janë përfaqësuesit e partive politike, ata që janë pjesë e KKZ-ve. Po mendoj që duhet ti zëvendësojmë, por organet e rednit duhet ta krijojnë sigurinë... Përmes një plani të detajuar mirë, në bashkëpunim me policinë puna joë të kryehet sipas planit operacional... duhet ti kontaktojmë subjektet...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, tha se nëse edhe alternativa e dytë dështon, a kemi ne alternativë të tretë...? Burim Ahmetaj, tha se gjithëcka bëhet në bazë të ligjit, dhe me këtë rast, nëse kemi refuzim nuk do të kemi komisione funksionale... Po ashtu, diskutoi edhe Alim Rama, pastaj Sami Hamiti, i cili tha se “ne jemi duke folur hipotetiksht” por, po pyes: ku do të shkojnë ata, ku do të vendosen...?

Čemailj Kurtiši, tha se ne gjatë mund të diskutojmë por për disa çështje as nuk jemi kompetent. Pra, nuk kam shumë shpresë, sepse nëse nuk ka siguri ne mund të angazhojmë njerëz por kjo nuk funksionon. Me analizen e sigurisë, ne s’kemi më tej pse të merremi. Por, nëse një person na vritet, ne s’kemi bërë asgjë...Bëhet fjalë për sigruin, nëse s’kemi siguri ne s’mund të bëjmë asgjë...!

3. Aktivitetet e ZRPPC

Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP tha në raportin e saj se, në bazë të detyrave tona, më 7 dhjetor kemi bërë tërehqjen e shortit për rënditjen e subjekteve politike në fletëvotim, dhe kjo është bërë për të dy palë zgjedhjet: më 18, dhe 25 dhjetor. Janë 5 subjekte politike...

Zyra ju njofton se kemi pranuar edhe dy kërkesa për tërheqje nga kandidat për asambleistë nga partia "Kosovski Serba".

Afati për akreditim të vëzhguesve, po vazhdon...por, deri më tani ende s'kemi asnjë lloj aplikimi...!

4. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarëve të Kuvendit Komunal në Prishtinë:

Sami Hamiti, tha se këshilli është takuar dhe ka shqyruar një kërkesë nga komuna e Prishtinës, kur Rita Zeneli për shkaqe personale ka dhënë dorëheqje nga radhët e asambleistës nga Lëvizja Vetëvendosje, dhe Radije Hoxha është rekomanduar për zëvendësim.

Në Rahovec, po ashtu e kemi një kërkesë ku Dafina Gashi nga subjekti politik AAK, e zëvendëson Besmira Bytyqin, anëtare të deritanishme në asamblenë komunale.

Të dy këto zëvendësime, këshilli e rekomandon KQZ –në për t'i proceduar më tej...

Miratohen me 11 vota.

5. Raport i Këshillave të KQZ-së:

1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i rritjes së numrit të votuesve në vendvotime:

Arianit Elshani, DOZ ka shqyrtuar rekomandimin për rritjen e numrit të votuesve për VV, ndërsa që në bazë të rregullës zgjedhore parashihet që numri të jetë deri në 750, por ne na lejohet rritja. Dhe ne, propozojmë që ky numër të rritet në 950...

Rritja, mundëson që të zvogëlohen numri i vendvotimeve nga 87 i vendvotimeve për të gjitha komunat, bie në 74 vendvotime. Ne rekomandojmë për miratim...

Anëtarët e KQZ –së me 11 vota për, miratuan këtë rekomandim.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtar për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen me datën 18.12.2022:

Arianit Elshani: KOZ ka shqyrtuar edhe raportin përfundimtar të Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen me datën 18.12.2022. Nurmi i votuesve për komuna, është:

Leposaviq, 13, 293 votues,

Zubin Potok, 6,636 votues,

Mitrovicë e Veriut, 18, 032 votues,

Zveçan: 6,978 votues.

Në total: **44 939** votues.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 11 vota për, mriatohet LPV.

3. Miratimi dhe shqyrtimi i Fletëvotimeve dhe Broshuave:

Arianit Elshani, DOZ ka shqyrtuar edhe rekomadnimet dizajnet e fletëvotimeve dhe broshuave, dhe i keni këto në imell...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 11 vota për, mriatohen fletëvotimet dhe broshurat.

4. Shqyrtimi dhe mriatimi i numrit të fletëvotimeve dhe broshurave:

Arianit Elshani, DOZ ka shqyrtuar edhe rekomadnimet për numrin e fletëvotimeve dhe të broshuave që duhet të prodhohen për këot zgjedhje. I keni në një fajll...

Në total, numri i fletëvotimeve që do të shtypen për kryetar komunash, është: 49, 000 (700 kopje – janë fletëvotime rezervë)

Në total, numri i fletëvotimeve që do të shtypen për kuvendet komunale, është: 18, 500 (300 kopje rezervë).

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 11 vota për, miratohet numri i fletëvotimeve dhe broshurave.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit operacional të sigurisë:

Arianit Elshani, DOZ ka shqyrtuar edhe planin e sigurisë. Ky plan, është si në cdo palë zgjedhje për hapat tanë, që nga momenti i hapjes së fushatës e deri te mbyllja e qevrave të votimit. Me këtë rast, plani është i detajizuar, dhe ne rekomandojmë për miratim...Dhe, pas kësaj, plani tu përcilelt organeve të sigurisë...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 11 vota për, miratohet plani i sigurisë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i listës finale të Qendrave të Votimit:

Arianit Elshani, DOZ ka shqyrtuar kërkesën për miratimin e “Listës” së Qendrave të Votimit dhe se e njëjta kërkesë, do tu përcillet edhe organeve të sigurisë para ditës së zgjedhjeve, gjatë ditës dhe pas saj... Fjala është për 44 QV ! Është listuar gjithcka, dhe e njëjta të publikohet edhe në ueb faqe...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 11 vota për, miratohet...

7. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarëve të KKZ-ve në Zubin Potok:

Arianit Elshani, DOZ ka shqyrtuar kërkesën zëvendësimit të anëtarëve të KKZ-ve në Zubin Potok. Po flasim për një anëtarë, bëhet fjalë për Raif Ferizin, i cili zëvendësohet nga Alber Ferizi. Rekomandoj që kjo kërkesë të miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 11 vota për, miratohet ky zëvendësim.

2.Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

1. Informatë nga AWEB

Kreshnik Radoniqi: Në takimin e sotëm të këshillit, ne e kemi trajtue njoftimin nga AWEB që, na ka njoftue se fonte që i kemi pas në si pjesë e asociacionit, me vendim të kuvendit – asamblesë së përgjithshme, fontet i janë bartur Sekretariatit të AWEB-it. Ne, e kemi trajtue shqetësimin tonë që s’na është mundësue me marrë pjesë në kuvendin e asamblesë, dhe po ashtu, do ta përgatisim një shkresë ku do të shprehim brengën tonë...Po ashtu, do ta shprehim një kërkesë tonën që, kur të organizojnë trajnime të na thërrasin, sepse ka dy vite që ne s’kemi asnjë ftesë...Dhe, do të kërkojmë që kur të kenë takime të nivelit të lartë, si “kuvendi i asamblesë”, ato të mbahen në shtetet që na kanë njoftë në mënyrë që ne të kemi mundësi të marrim pjesë, pra të mos kemi probleme...

Ilir Gashi, tha se, jo vetëm për asamble por edhe për trajnime dhe ngjashëm, të kihet parasysh që ne të merremi parasysh...

Te ndryshme !